

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaDecor®-803 Plus

SHTRESË NIVELUESE PËR SISTEMIN E LLAÇIT DEKORATIV ME BAZË ÇIMENTOJE SIKADECOR®



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Llaç çimentoje me 2 përbërës dhe i modifikuar me polimere që përmban agregate të përzgjedhura dhe aditivë, i përshtatshëm për riprofilizimin e sipërfaqes përpara aplikimit të SikaDecor®-801 Nature.

### PËRDORIMET

Rregullim dhe riprofilizim përpara aplikimit të mikroçimentos SikaDecor®-801 Nature mbi:

- Llaçe me bazë çimentoje
- Tulla
- Sipërfaqe të shtruara me pllaka, etj.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përbërës të gatshëm, përzjerje e lehtë
- Aplikim i thjeshtë
- Tkurrje e ulët
- Llaç për aplikim të përgjithshëm (GP) sipas EN 998-1
- Kategoria CT-C60-F10 sipas EN 13813

### MIRATIME / STANDARDE

- Llaç për përdorim të përgjithshëm (GP) për suvatime në mjedis të brendshëm dhe të jashtëm sipas EN 998-1:2010, Deklaratë Performance 32834282 dhe mbart markën CE.
- Material me bazë çimentoje për shtrimin e dysHEMEVE Kategoria CT-C60-F10 sipas EN 13813, Deklaratë Performance 92159990 dhe mbart markën CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Llaç me bazë çimentoje i modifikuar me polimere	
<b>Ambalazhi</b>	Përbërësi A:	bidon 5 kg
	Përbërësi B:	thes 25 kg
	Përbërësit A+B:	njësi 30 kg
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Përbërësi A:	Lëng qumështor
	Përbërësi B:	Pluhur i bardhë
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe të freskëta (+5°C deri në +35°C). Të mbrohet nga ngrica.	
<b>Përmasa maksimale e kokrrizës</b>	~ 0.3 mm	
<b>Dendësi vëllimore (bulk density)</b>	~ 1.33 kg/lit	

### TË DHËNA TEKNIKE

<b>Rezistenca ndaj ngjeshjes</b>	≥ 60MPa në 28 ditë	(EN13892-02 & EN1015-11)
----------------------------------	--------------------	--------------------------

Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje  $\geq 10\text{MPa}$  në 28 ditë (EN13892-02)

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje  $\geq 2.5\text{MPa}$  në 28 ditë (EN1015-12)

Koeficienti i zgjerimit termik  $1.05\text{W/m} \cdot \text{K}$  ( $\lambda_{10}$ , i thatë) (EN 1745, vlera mesatare e tabelës P=50%)

Reagimi ndaj zjarrit

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Veshja	Produkti	Konsumimi
	Muret: Prajmer (sipërfaqe me bazë çimentoje)	SikaTop®-10	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
	Muret: Prajmer (sipërfaqe gipsi)	Sika® Primer-11 W	~ 0.2 - 0.5 kg/m <sup>2</sup>
	Dyshemetë: Prajmer	Sikafloor®-156/-161 dhe spërkatje me rërë kuarci 0.4-0.7mm	
	Shtresa niveluese	2 - 3 SikaDecor®-803 Plus	~ 2.0 kg/m <sup>2</sup> /mm
	Shtresa dekorative	2 - 3 x SikaDecor®-801 Nature	~ 0.35-0.45 kg/m <sup>2</sup> /shtresë
	Izoluesi 1 (transparent, i shkëlqyeshëm, zona të brendshme)	Sikafloor®-169*	~ 0,15 kg/m <sup>2</sup> /shtresë
	Izoluesi 2 (transparent, mat, zona të jashtme & të brendshme)	Sikafloor®-304 W	~ 0,13 kg/m <sup>2</sup> /shtresë
	Izoluesi 3 (transparent, mat, zona të jashtme)	Sikafloor®-410	~ 0,15 kg/m <sup>2</sup> /shtresë

\* Në këtë rast ngjyra përfundimtare është më e theksuar krahasuar me listën e ngjyrave SikaDecor®.

Sipas dëshirës: Sika Decor®-803 Plus mund të përforcohet me rretjen prej fibrash qelqi Sika® Fibernet.

Sikagard®-907 W mund të aplikohet sipas dëshirës si një izolues poresh përpara aplikimit të izoluesit përfundimtar.

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik të Sika-s.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 5 : 25
Konsumimi	~ 2.0 kg/m <sup>2</sup> /mm
Trashësia e shtresës	2 mm min. / 8 mm max.
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.
Koha e pritjes / mbiveshja	Mund të bluhet pas 5-8 orësh (+23°C) ose sapo veshja të jetë mjaftueshëm e fortë për të përballuar procesin e bluarjes.

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë pa pluhur, grimca të lira, ndotje sipërfaqësore si vaj, graso, veshje të vjetra. Përdorni një prajmer të përshtatshëm.

Në rast aplikimi mbi pllakat e vjetra qeramike, këto duhet të jenë ngjitura mirë mbi nënshtresë dhe të smerilizuara.

Në rast dyshimi kryeni një testim paraprak.

### PËRZIERJA

Përziene Përbërësin A (lëng qumështor) për ta homogjenizuar. Hidheni brenda një kove të përshtatshme dhe shtoni gradualisht Përbërësin B (pluhurin), ndërsa përziene me mikserin elektrik në shpejtësi të ulët (~ 300 rpm). Përziene për të paktën 3 minuta, derisa të përftohet një përzierje homogjene dhe pa kokrriza.

### APLIKIMI

Aplikoni SikaDecor®-803 Plus e përzierë mbi nënshtresë duke përdorur një mallë krehër në trashësinë e dëshiruar. Midis shtresave të SikaDecor®-803 Plus, sipërfaqja duhet të laget deri në saturim. Sigurohuni se prajmeri i përdorur mbi muret (SikaTop®-10, Sika® Primer-11 W) është ende i ngjitsëm gjatë aplikimit të llaçit për riprofilizim (“i lagësht mbi të lagësht”).

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Gjatë aplikimit dhe procesit të maturimit, temperatura duhet të jetë e shkallës midis +5°C deri në +35°C.
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura.
- Mos shtoni ujë shtesë ndërsa jeni duke niveluar dhe përfunduar sipërfaqen, pasi kjo gje do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje.
- Mbroni materialin e freskët nga ngrica, era dhe dielli.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaDecor®-803 Plus

Prill 2019, Botimi 01.01

020815030010000257

SikaDecor-803Plus-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf